



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 138

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 26 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË
DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nëpërmjet përdorimit të burimeve njerëzore, konkretisht punonjësve të administratës.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 26 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Drejtoresha e Shkollës Nëntë Vjeçare Drenovicë, Drejtori dhe nëndrejtoresha e Gjimnazit “Muhamer Janina” janë parë dhe konstatuar se kanë realizuar takime dhe mbledhje me zyrtarë të Partisë Socialiste. Personat në fjalë kanë nisur shkeljet e para të rregullave të barazisë në garën elektorale, duke realizuar takime me përfaqësues të Partisë Socialiste.”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

Data: 22.02.2025

Nr: 138
Ora: 12:00



“Për mos fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 26 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mos fillim të procedurës administrative të denoncimit nr. 26 ID, datë 18.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI